



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 54

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRISË E  
FINANCIVE, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**SUBJEKT:** Ministria e Financave

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrisë së Financave për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Ministria e Financave ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 22.1.2025, ora 09:30, në njësinë Administrative Nr. 9, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “*Takimi - Due Diligence për zhvillimin e Eurobondit 2025. Me pjesëmarrjen e Ministrive të ndryshme dhe insitucioneve të tjera, si Banka e Shqipërisë, INSTAT, etj.. Ky proces realizohet ne kuadër të vlerësimit të vendit nga bankat bashkëdrejtuese të procesit të Eurobondit përpara emetimit*”.
- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 21.1.2025, ora 16:30, në njësinë Administrative Nr. 9, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “*Mbledhja periodike e Këshillit Tatimor, mbi diskutime që kanë të bëjnë me përmirësimet e kuadrit ligjor fiskal, aktet dhe udhëzimet. Anëtarët e përhershëm të Këshillit janë përfaqësues nga shoqata dhe dhoma të*

Data: 31.1.2025 Nr: 54  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë së Financave për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

*tregtisë, të cilët diskutojnë në lidhje me rendin e ditës dhe njihen me zhvillimet më të fundit në fushën e çështjeve fiskale”.*

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 22.1.2025, ora 10:30, në njësinë Administrative Nr. 5, Kryesia e Kuvendit, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “Diskutimi në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë mbi Aktin Normativ për disa ndryshime në Buxhetin 2024.”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrisë së Financave, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrisë së Financave ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Në datën 20.1.2025, personi përgjegjës për raportim është pajisur me konfirmimin për kredencialet. Edhe pse në tejkallim të afateve, vlerësuam për të raportuar, për të qenë sa më korrekt në përmbushje të detyrimeve. Për shkak të disa konfirmimeve të minutës së fundit, vendosëm të pasqyronim aktivitetet pavarësisht afateve.

Në përfundim të shqyrtimit, pas verifikimit në NRI, konfirmohet se regjistrimi i personit përgjegjës për raportim i Ministrisë së Financave në NRI është bërë në datën 20.1.2025. Për këtë arsye Ministria e Financës nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për raportimin e veprimtarive. Në këtë rast mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë së Financave.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**